

# UDHËZUES MBI SHMANGIEN E RREZIKUT NGA LARTPËRÇUESIT DHE SHËRBIMET NËNTOKËSORE

Ky Udhëzues u drejtohet punëdhënësve, menaxherëve dhe personave të tjerë brenda vendit të punës që kanë një përgjegjësi për shëndetin dhe sigurinë. Ky dokument duhet të përdoret si një ndihmë për zhvillimin e sistemeve të sigurta të punës, ndërsa puna kryhet në afërsi të shërbimeve ajrore dhe nëntoksore.



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija,*

*Rada i Trasfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers*

Inspektorati i Punës/ Inspektorata Rada/ Labour Inspectorate

Për më shumë informata, vizitoni <https://ip.rks-gov.net/>

# PËRMBAJTJA

HYRJE.....	1
FUSHËVEPRIMI DHE QËLLIMI .....	1
IDENTIFIKIMI DHE MENAXHIMI I RREZIQEVE NGA SHËRBIMET NËNTOKËSORE .....	2
PUNA E SIGURT AFËR SHËRBIMEVE NËNTOKËSORE .....	3
GËRMIMI I SIGURT.....	4
PUNA NËN APO AFËR LARTPËRÇUESË.....	7
PARANDALIMI I AKSIDENTEVE NË KONTAKT ME LARTPËRÇUES .....	8
KALIMI NËN LARTPËRÇUES .....	9
KONTROLLIMI I PUNËS.....	10
PROCEDURAT EMERGJENTE .....	10
ÇËSHTJET E NDRYSHME PËR PUNËN ME.....	11
LARTPËRÇUES DHE KABLOT NËNTOKËSORE.....	11
AUDITIMET .....	11
VËREJTJET PËRFUNDIMTARE.....	11
SHTOJCA .....	12



## HYRJE

Ky Udhëzues përshkruan rreziqet e mundshme të punës pranë lartpërçuesve dhe shërbimeve nëntokësore dhe ofron këshilla mbi reduktimin e rreziqeve. Ai merret më shumë me rreziqet për shëndetin dhe sigurinë se sa me dëmtimin e shërbimeve. Sidoqoftë, masat paraprake të marra që zvogëlojnë rreziqet për shëndetin dhe sigurinë e njerëzve, do të zvogëlojnë në përgjithësi edhe rrezikun e dëmtimit të shërbimeve, të cilat mund të paraqesin rrezik të drejtpërdrejtë apo të tërthortë mbi shëndetin dhe sigurinë e njerëzve.

Një numër i konsiderueshëm i aksidenteve ndodhin në të gjithë botën, derisa njerëzit janë duke punuar në afërsi të lartpërçuesve dhe shërbimeve nëntokësore. Megjithëse goditja elektrike është gjëja e parë që ndodhë kur njerëzit vijnë në kontakt me energjinë elektrike, ata që kanë parë efektet e dëmtimit tronditen nga sasia e nxehtësisë, dritës dhe zhurmës që mund të rezultojë nga një ndezje elektrike. Një numër i konsiderueshëm i këtyre aksidenteve ndodhin derisa njerëzit janë duke punuar në afërsi të aparateve elektrike sipër dhe atyre nëntokësore. Shërbime të tjera nëntokësore siç janë tubat e gazit dhe kanalizimeve gjithashtu mund të jenë të rrezikshme nëse goditen. Tubat e ujit dhe kabllot e telekomit, megjithëse më pak të rrezikshëm, mund të shkaktojnë dëme të konsiderueshme dhe të shkaktojnë shpenzimet të larta për riparimin e tyre. Ky Udhëzues është bërë për të siguruar udhëzime të përgjithshme se si ju dhe punëtorët tuaj mund t'i shmangeni rrezikut për t'u bërë pjesë e këtyre statistikave dhe gjithashtu pengesave dhe ndërlikimeve financiare që mund të rrjedhin nga dëmtimi i këtyre shërbimeve.

## FUSHËVEPRIMI DHE QËLLIMI

Ky Udhëzues u drejtohet të gjithë atyre që janë të përfshirë në kryerjen, përgatitjen, dhe menaxhimin e punëve në ose afër lartpërçuesve dhe shërbimeve nëntokësore. Ky Udhëzues do të jetë në përdorim të pronarëve dhe operatorëve të shërbimeve të tilla. Ai përshkruan rreziqet e mundshme të punës pranë shërbimeve nëntokësore dhe lartpërçuesve dhe jep këshilla se si të zvogëlohen rreziqet e drejtpërdrejta për shëndetin dhe sigurinë e njerëzve, si dhe rreziqet e tërthorta që vijnë nga dëmtimi i shërbimeve.

Puna që përfshin shërbimet nëntokësore dhe të lartpërçuesve bartë rrezikun e lëndimeve vdekjeprurëse ose të rënda dhe është një rrezik i veçantë në kantieret e ndërtimit. Ky Udhëzues përshkruan se si të identifikoni me saktësi pozicionin e shërbimeve nëntokësore, të gërmoni dhe të punoni pranë instalimeve të tilla në mënyrë të sigurt. Këtu gjithashtu përshkruhet se si të kryhet puna në mënyrë të sigurt pranë kabllave ajrore, si të mos këputen linjat, si të ngrihen barrierat dhe si të përdoren pajisjet për të mos dështuar në punë.



# IDENTIFIKIMI DHE MENAXHIMI I RREZIQEVE NGA SHËRBIMET NËNTOKËSORE

Dëmtimi i shërbimeve nëntokësore mund të shkaktojë lëndime vdekjeprurëse ose të rënda, si dhe ndërprerje të konsiderueshme dhe dëme mjedisore; ai gjithashtu mund të vonojë zbatimin e projektit dhe të shkaktojë shpenzime të konsiderueshme.

**Kabllo elektrike:** Lëndimet zakonisht shkaktohen nga efektet shpërthyes të harkut elektrik dhe nga çdo zjarr ose flakë e lidhur që mund të rezultojë kur një kablo depërtohet nga një objekt i mprehtë siç është maja e një vegle. Efektet e tilla mund të ndodhin gjithashtu kur një kablo shtypet aq shumë sa për të shkaktuar kontakt të brendshëm midis përcuesve, ose midis mbështjellësit metalik dhe një ose më shumë përcuesve. Zakonisht, lëndimet janë djegie të rënda - potencialisht vdekjeprurëse - në duar, fytyrë dhe trup. Goditja elektrike është e mundur por ndodh më rrallë.

Incidentet mund të vijnë gjithashtu nga kabllo, lidhjet dhe përfundimet të cilat janë dëmtuar, por kanë mbetur të pa raportuara dhe të parregulluara, ose që janë përkeqësuar me kalimin e kohës.

Shërbime të tjera pranë vendpunishteve, të tilla si tuba gazi të plastikës, gjithashtu mund të jenë të rrezikuara nga kabllo të dëmtuara të energjisë elektrike. Kjo mund të rezultojë në shpërthime dhe paraqet një rrezik më të madh nga zjarri.

**Tubat e gazit:** Dëmtimi i tubave dhe lidhjeve të gazit mund të shkaktojë rrjedhje që mund të shpije drejt paraqitjes së zjarrit apo ndonjë shpërthimi. Ekzistojnë dy lloje të dëmtimeve:

1. Dëmtimi që shkakton një rrjedhje të menjëhershme;
2. Dëmtimi që shkakton rrjedhje e cila paraqitet më vonë.

Dëmi mund të ndodhë kur kryhet puna, ose më pas; për shembull, rivendosija e dobët mund të lërë një tub jo të mbështetur në mënyrë adekuate ose që i nënshtrohet veprimit të forcave të pabarabarta. Rreziku nga rrjedhja e gazit të lëngshëm (LPG) është më i madh sesa nga rrjedhja e gazit natyror pasi është më i rëndë se ajri dhe nuk shpërndahet aq lehtë. Ai gjithashtu mund të përshkojë distanca të mëdha nën nivelin e tokës përpara se të grumbullohet në nivel të ulët, për shembull në bodrume.



**Tubat e ujit dhe kanalizimet:** Megjithëse dëmtimi i tubave të ujit ka më pak të ngjarë të rezultojë në lëndim, mund të ndodhin gjërat në vijim:

- Një rrymë e ujit nga tubi kryesor mund të ketë shtypje dhe intensitet aq të lartë sa lëndojë një person. Kjo rrymë uji mund të përmbajë gurë ose gjësende të tjera të forta nga toka rreth tubit.
- Rrjedhjet e ujit nga tubat nëntokësorë mund të ndikojnë në kabllo që ndodhen afër dhe të dobësojnë mbështetjen për strukturat e tjera.



- Dëmtimi i tubave kryesore në rrjet mund të rezultojë në përmytje, si rrjedhojë e të cilave mund të lindin rreziqe tjera nga përmytja ose shembja e shpejtë e mbështetjes anësore të gërmimit; uji mund të hyjë në tubat e gazit nëse edhe ato janë të dëmtuara.

Përderisa disa ujëra të zeza pompohen me shtypje, kanalizimet zakonisht punojnë me forcën e gravitetit dhe rreziqet kryesore nga dëmtimi i tyre për shëndetin e punëtorëve lidhen me ekspozimin e tyre me ujërat e zeza të papërpunuara, mundësia e shembjes së tokës dhe mundësia ndotjes së mjedisit.

**Tubacione të tjera:** Rreziku që vjen nga dëmtimi i tubacioneve të tjera varet nga natyra e lëngut që bartet. Lëngjet dhe rreziqet e tyre përfshijnë:

- Lëngje dhe gazra të ndezshme - rreziqe zjarri dhe shpërthimi;
- Lëngje në presion të ngritur - rreziku i dëmtimit nga lëshimi i papritur i përmbajtjes;
- Lëngje dhe gazra toksike - rreziku i helmimit;
- Gazra inerte si azoti dhe argoni - rreziku i asfiksimit.

Shumë shpesh një lëng mund të paraqesë një kombinim të rreziqeve; për shembull, një lëng mund të jetë edhe toksik edhe i ndezshëm.

**Kabllo e telekomunikimit:** Dëmtimi i kabllove telekomunikuese dhe kabllove të televizionit kërkojnë riparime të shtrenjta dhe mund të shkaktojë ndërprerje të konsiderueshme për ata që mbështeten në sistem. Sidoqoftë, rreziku i lëndimit personal të punëtorëve kryesisht është shumë i ulët.

Gazrat e ndezshme dhe toksike mund të hyjnë në kanalet që përmbajnë kabllo, veçanërisht nëse kanali është i dëmtuar. Gazra të tillë mund të grumbullohen në dhoma, puseta, etj., dhe paraqesin rrezik për punëtorët që janë të detyruar të punojnë atje.

## PUNA E SIGURT AFËR SHËRBIMEVE NËNTOKËSORE

**Një sistem i sigurt ka tre elemente bazike:**

1. Planifikimin e punës;
2. Zbulimin, identifikimin, dhe shënjimin e kabllove nëntokësore;
3. Gërmimin e sigurtë/praktika të sigurta gërmimesh.

Këto elemente kryesore plotësojnë njëri-tjetrin dhe të tre janë thelbësor për punën pranë shërbimeve nëntokësore. Në paragrafët e mëposhtëm janë dhënë hollësi rreth secilit element.

Kushdo që planifikon ose ndërmerr ndonjë punë që mund të pengojë shërbimet nëntokësore duhet të kontaktojë pronarët/operatorët e atyre shërbimeve për informacione në lidhje me vendndodhjen dhe statusin e tyre. Pronarët dhe operatorët duhet të sigurojnë çdo informacion përkatës në lidhje me vendndodhjen e shërbimeve në zonën e punës.



Pronarët dhe operatorët e shërbimeve duhet të jenë të përgatitur për të ndihmuar në lokalizimin dhe identifikimin e shërbimeve (për shembull, duke dërguar një përfaqësues në vendpunim). Planet afatgjata ose rregullimet formale për bashkëpunim mund të jenë të nevojshme me ndërmarrjet e tjera, autoritetet lokale dhe kontraktorët që kryejnë gjurmime në rrugë.

Puna duhet të planifikohet ashtu që të shmangen shërbimet nëntokësore. Kur një gjë e tillë nuk është e mundur, duhet të zhvillohen plane për të minimizuar rrezikun e dëmtimit të shërbimeve në zonën e punës. Zbulimi i shërbimeve nëntokësore kërkon informacione nga ata që zotërojnë shërbimet. Individët me përvojë të mjaftueshme dhe njohuri teknike duhet të kryejnë një studim gjithëpërfshirës të zonës së punës duke përdorur mjetet dhe pajisjet e duhura të studimit.

Kur bëhen gjurmime, është e rëndësishme që:

- Ata që mbikëqyrin dhe kryejnë punën kanë aftësi, njohuri dhe përvojë të mjaftueshme për të kryer punën në mënyrë të sigurt dhe që dinë të përcaktojnë dhe përdorin praktikën e sigurt të punës ;
- Shenjat e duhura të trafikut përdoren në autostrada;
- Shmangen rreziqet nga burime të tjera, të tilla si shembja e gjurmimeve;
- Janë në dispozicion shërbimet e duhura të mirëqenies për ata që kryejnë punën.

### **Marrja e informacioneve mbi shërbimet**

Merrni plane ose informata të tjera të përshtatshme për të gjitha shërbimet nëntokësore për zonën ku planifikohet të zhvillohet puna. Kur është e mundur, konsultoheni me pronarët/operatorët. Mos harroni që për disa shërbime mund të ketë më shumë se një pronar/operator. Në komunat përkatëse ku zhvillohen aktivitetet, ne mund të kërkojmë skica/plane prej tyre, dhe kjo mund të thjeshtësojë procesin e identifikimit të shërbimeve nëntokësore në zonën e punës.

Kur nuk është e mundur që ata që punojnë në marrjen e informatave, siç mund të jetë rasti kur duhet të ndërmerret ndonjë punë emergjente, puna duhet të kryhet sikur të ketë shërbime nëntokësore në zonë.

## **GËRMIMI I SIGURT**

Përcaktoni metodën ose teknikën për gjurmimin pranë shërbimeve nëntokësore para se të fillojë puna, me vlerësimin e duhur të rrezikut, duke marrë parasysh:

- Natyrën dhe fushëveprimin e punës;
- Llojin, pozicionin dhe statusin e shërbimeve nëntokësore;
- Kushtet e tokës;
- Kufizimet e terrenit.



Ata që janë duke kryer punën, duhet të pajisen me një plan të shkruar, i cili përfshinë informata në lidhje me vendndodhjen dhe natyrën e shërbimeve nëntokësore. Ata duhet të jenë aftë, të pajisur me pajisje mbrojtëse personale (PMP) dhe pajisje pune të përshtatshme, dhe gjithashtu duhet t'u ofrohet kohë e mjaftueshme në dispozicion.



Shërbimet e identifikuar duhet të ekspozohen me kujdes dhe të shënohen në mënyrë të qartë.

Duhet të sigurohet leje veçanërisht për punë, të cilat paraqesin rrezik. Kjo do të përfshijë autorizimin me shkrim nga një person përgjegjës, duke identifikuar punën që duhet bërë dhe masat paraprake që duhen ndërmarrë. Një leje siguron që do të ketë mbikëqyrje dhe monitorim të përshtatshëm për t'u siguruar që kushtet e lejes janë respektuar.

Mbushja e gërmimeve duhet të mbështesë dhe mbrojtë siç duhet shërbimet nëntokësore. Betoni nuk duhet të përdoret për të mbyllur shërbimet kur bëhet një mbushje e tillë.

Nëse shërbimet nëntokësore dëmtohen gjatë gërmimit ose punës pasuese, informoni pronarin/operatorin. Në rastin e kablove elektrike, tubave të gazit, tubacioneve të tjera ose rrjetit të ujit me presion të lartë, planifikoni që t'i mbani njerëzit larg zonës derisa të riparohet ose të sigurohet nga pronari/operatori.

Të gjithë ata që punojnë për të ekspozuar shërbimet dhe ata që i mbikëqyrin ato duhet të jenë kompetentë për ta bërë këtë. Ata duhet të kenë informacion, udhëzime dhe trajnim të mjaftueshëm për:

- Të kuptuar rrezikun në lidhje me sigurinë e shërbimeve të dëmtuara;
- Të përdorur mjetet e zbulimit;
- Të praktikuar teknikat e sigurta të gërmimit dhe për të kuptuar vlerën e gërmimit me duar dhe rreziqet nga përdorimi i mjeteve elektrike ose gërmuesve mekanik.

Puna e gërmimit duhet të ndjekë praktika të sigurta të gërmimit. Sapo të jetë përdorur një pajisje zbuluese për të përcaktuar pozicionin dhe rrugën, gërmimi mund të vazhdojë, duke hapur vrima provuese (duke përdorur mjete të përshtatshme dore ose gërmim me vakum), sipas nevojës, për të konfirmuar pozicionin e çdo kablove të zbuluar.

Kujdes të veçantë duhet t'i kushtohet sa herë që gërmohet lart ose afër shërbimit të supozuar nëntokësor.

Ju duhet të planifikoni dhe menaxhoni me kujdes gërmimin mekanik, i cili është një prej shkaktarëve të zakonshëm të dëmtimit të shërbimeve. Një person tjetër duhet të ndihmojë shoferin e eskavatorit, nga një pozicion ku ata mund të shohin me siguri gërmimin dhe të paralajmërojnë shoferin për ndonjë shërbim ose pengesë tjetër. Ky person duhet të mbetet jashtë rrezes së funksionimit të krahut dhe kovës së eskavatorit.



Në rast se goditet një kablo, shoferi duhet të udhëzohet që të qëndrojnë në kabinë. Nëse shoferët zbresin poshtë, ata mund të goditen nga rryma elektrike. Kur goditet një kablo, zona duhet të izolohet dhe sigurohet; askush nuk duhet të afrohet afër gërmimit ose t'i afrohet eskavatorit ose kabllos derisa pronari i kabllos ta ketë siguruar kabllon e dëmtuar.

Rreziku i krijuar nga dëmtimi i një tubi gazi me një eskavator është shumë më i madh sesa nëse dëmtimi me një vegël elektrike të dorës, e kundërta vlen për punën pranë kabllove elektrike.

Mos harroni se efektet mund të mos ndodhin vetëm në pikën e goditjes, për shembull:

- Dëmtimi i një shërbimi të lidhur mund të rezultojë në dëmtime të padukshme të lidhjes brenda ndërtesës;
- Gazi nga një tub i dëmtuar mund të kalojë përgjatë vijës së një tubi shërbimi në ndërtesë, duke shkaktuar grumbullimin e rrezikshëm të gazit aty.

Mjetet elektrike të dorës mund të dëmtojnë shërbimet nëntokësore dhe duhet të përdoren me kujdes derisa të përcaktohet pozicioni i saktë i shërbimeve. Mund t'i përdorni ato për të thyer një sipërfaqe të shtruar ose prej betoni mbi një shërbim, përveç nëse ka ndonjë tregues që shërbimi është veçanërisht i cekët ose shumë afër sipërfaqes dhe mund të prishet.



Mjetet e dorës janë një burim i zakonshëm i aksidenteve kur përdoren gabimisht. Sidoqoftë, kur përdoren me kujdes, ato normalisht mund të ofrojnë një mënyrë të duhur për ekspozimin e shërbimeve.

**Bëni të gjitha përpjekjet për të gërmuar përgjatë shërbimeve e jo drejtëpërdrejt mbi to. Shmangni përdorimin e mjeteve elektrike të dorës mbi shërbime, përveç nëse:**

- Shërbimi tashmë është ekspozuar duke gërmuar nën sipërfaqen që duhet të hapet dhe janë në një thellësi të sigurt (të paktën 300 mm) nën pjesën e poshtme të sipërfaqes së materialit të fortë; ose
- Janë marrë masat paraprake fizike për të parandaluar goditjen e mjetit në shërbim.

Eskavatorët mekanik dhe mjetet elektrike mund të përdoren për t'i thyer sipërfaqet e forta, kur studimi ka provuar se nuk ka shërbime, ose ato janë mjaft të thella në mënyrë që të mos dëmtohen nga mjete të tilla.

Përdorimi i mjeteve elektrike të dorës për të prishur sipërfaqet e forta shpesh rezulton në aksidente. Kur është e mundur, përdorni vetëm vegla elektrike 500 mm ose më larg vijës së treguar të një shërbimi të groposur në ose nën një sipërfaqe të fortë. Pasi ta keni bërë këtë, shërbimi duhet të lokalizohet duke gërmuar me duar me kujdes nën sipërfaqen e fortë. Gradualisht hiqni sipërfaqen e fortë derisa të ekspozohet shërbimi. Nëse shërbimi nuk ekspozohet kështu, atëherë supozoni që është i futur brenda sipërfaqes së fortë.



**Përdorni lokalizues të kablllove si mjet udhëzues për të ditur thellësin kur bëni gërmim. Margjina e sigurisë 500 mm mund të zvogëlohet:**

- Kur bllokimi i shërbimeve e bën atë të porealizueshëm; ose
- Kur pengesat sipërfaqësore kufizojnë hapësirën në dispozicion; por vetëm nëse drejtimi i shërbimit është identifikuar nga planet, konfirmuar nga një mjet lokalizues, dhe janë marrë masat paraprake shtesë për të parandaluar dëmtimin e shërbimeve.



**Ju gjithashtu duhet të:**

- Merrni parasysh ventilimin ose furnizimin me ajër në të gjitha zonat e punës kur punoni me gërmime (ato mund të jenë hapësira të kufizuara);
- Merrni parasysh mbrojtëset (rrethojat) rreth gërmimeve të thella;
- Merrni parasysh kalimet e sigurta gjatë gërmimeve të thella;
- Ruani si duhet pajisjet dhe materialet pranë gërmimeve të thella;
- Merrni parasysh ndriçimin e mjaftueshëm në gërmimet e thella;
- Merrni parasysh vendosjen e një numri të mjaftueshëm të shenjave paralajmëruese pranë gërmimeve të thella.

## PUNA NËN APO AFËR LARTËPËRQUESËVE

Aty ku puna duhet të kryhet afër ose nën lartpërçues, p.sh. punimet në rrugë, shtrirja e tubave, prerja e barit, punët bujqësore dhe ngritja e strukturave, dhe nuk ekziston rreziku i kontaktit aksidental ose mos respektimit të distancës së kërkuar, nuk kërkohen masa të tjera paraprake.

Sidoqoftë, vlerësimi juaj i rrezikut duhet të marrë parasysh çdo situatë që mund të çojë në rrezik nga lartpërçuesit.



Për shembull, ju duhet të merrni parasysh nëse dikujt i duhet të qëndrojë mbi ndonjë makinë ose në platformën e skeles dhe të ngris diçka të gjatë mbi kokë, ose nëse lartësia e kombinuar e një ngarkese në një kamion të ulët është mbi distancën që konsiderohet si e sigurt. Nëse kjo lloj situatë mund të ndodhë, ju duhet të merrni masa paraprake.



Nëse nuk mund të shmangni punën tranzitore ose me kohë të shkurtër, në nivelin e tokës, kur ekziston rreziku i kontaktit, për shembull nga, lëvizja e vinçave ose rimorkiove ose personave që mbajnë mjete dhe pajisje, duhet të vlerësoni me kujdes rreziqet dhe masat paraprake. Ju duhet të informoheni se a mund të ndërpritet rryma në lartpërçues derisa të kryhet puna.

Kur ndërtesat ose strukturat ngriten afër ose nën lartpërçues, rreziku i kontaktit rritet për shkak të gjasave më të mëdha të kalimit të distancave që janë të sigurta. Kjo vlen edhe për ndërtimin e strukturave të përhershme edhe ato të përkohshme të tilla si serat, çadrat, tendat, shtizat e flamurit, shtyllat e rugbi-t, objektet e teleskopëve etj. Në shumë aspekte këto struktura të përkohshme paraqesin një rrezik më të lartë sepse puna shpesh përfshin manipulimin me dorë të objekteve të gjata përçuese.

## PARANDALIMI I AKSIDENTEVE NË KONTAKT ME LARTPËRÇUES

Menaxhimi i mirë, planifikimi dhe konsultimi me palët e interesuara para dhe gjatë çdo pune afër lartpërçuesëve do të zvogëlojë rrezikun e aksidenteve. Kjo vlen për çdo lloj pune që planifikohet ose ndërmerret, edhe nëse puna është e përkohshme ose me kohëzgjatje të shkurtër. Ju duhet të menaxhoni rreziqet nëse keni ndërmend të punoni në një distancë prej së paku 10 m nga teli më i afërt, të matur nga niveli i tokës në pozicionin horizontal.

### Largoni rrezikun

Mënyra më efektive për të parandaluar kontaktin me lartpërçuesit është duke mos kryer punë atje ku ekziston rreziku i kontaktit ose afrimit me tela.

### Shmangia e rrezikut nga lartpërçuesit

Nëse nuk mund të shmangni punën pranë lartpërçuesëve ku ekziston rreziku i kontaktit ose afrimit me tela, ju duhet të konsultoheni me pronarin e tyre për të zbuluar nëse linja mund të devijohet përgjithmonë nga zona e punës ose të zëvendësohet me kablllo nëntokësorë.

Kjo shpesh do të jetë e papërshtatshme për punë jo të rregullta, afat-shkurtra ose punë kalimtare.



Nëse kjo nuk mund të bëhet dhe mbetet rreziku i kontaktit ose afrimit me tela, shikoni nëse lartpërçuesit mund të shkyçen përkohësisht gjatë punës. Pronarit të linjës do t'i duhet kohë për të shqyrtuar dhe vepruar sipas këtyre kërkesave dhe mund të kërkojë pagesë për çdo punë të bërë.



## Kontrolli i rrezikut

Nëse lartpërçuesi nuk mund të largohet ose çaktivizohet dhe nuk ka asnjë alternativë tjetër për të kryer punën pranë tij, ju duhet të mendoni se si mund ta kryeni punën në mënyrë të sigurt. Nëse puna nuk mund të kryhet në mënyrë të sigurt, atëherë mos punoni fare.

Vlerësimi i riskut specifik për punën tuaj do t'ju ndihmojë në marrjen e vendimit. Gjërat që duhet marrë parasysh si pjesë e vlerësimit tuaj të rrezikut përfshijnë:

- Tensioni dhe lartësia e telave mbi tokë. Lartësia e tyre duhet të matet nga një person i trajnuar duke përdorur pajisje matëse pa kontakt;
- Natyra e punës edhe nëse ajo do të kryhet afër ose nën lartpërçues, përfshirë qasjen nën tela - nëse është e nevojshme;
- Madhësia dhe shtrirja e çdo makinerie ose pajisje që do të përdoret pranë lartpërçuesit;
- Distanca e nevojshme ndërmjet telave dhe makinerive ose pajisjeve dhe çdo strukture që ngritet. Nëse ka ndonjë dyshim, pronari i lartpërçuesit do të jetë në gjendje t'ju këshillojë për distancat e duhura;
- Kushtet e vendit, p.sh. terreni jo i rrafshët mund të ndikojë në qëndrueshmërinë e impiantit.
- Kompetenca, mbikëqyrja dhe trajnimi i njerëzve që punojnë në kantier. Nëse linja mund të shkyçet vetëm për periudha të shkurtra, caktoni kalimin e impiantit të gjatë dhe, për aq sa është e mundur, punët e tjera rreth linjës për ato periudha kohore.

**Mos i ruani ose grumbulloni sendet afër lartpërçuesve kur mund të cenohen distancat e sigurisë nga njerëzit që qëndrojnë mbi to.**

## KALIMI NËN LARTPËRÇUES

Nëse pajisjet ose makineritë që tejkalojnë distancat e sigurisë duhet të kalojnë nën lartpërçues, ju duhet të krijoni një rrugë kalimi përmes pengesave.

Në një situatë të tillë:

- Mbajeni numrin e kalimeve në minimum;
- Përcaktoni rrugën e kalimit duke përdorur mur rrethues dhe vendosni kunja drejtimi në secilin skaj për të vepruar si porta duke përdorur material të ngurtë, jo përçues, p.sh. prej drurit ose plastikës, për kunjat që janë, për shembull, me vija të kuqe dhe të bardha;
- Nëse kalimi është shumë i gjerë dhe nuk mund të kufizohet me kunja jopërçues, ju mund të përdorni tela çeliku, të tokëzuar në secilin skaj, ose litarë plastikë me flamuj të varur në to. Këto duhet të pozicionohen më larg lartpërçuesëve për të parandaluar shtrirjen e tyre dhe zvogëlimin e distancës së sigurisë nga lëvizja e impiantit përgjatë shtegut;
- Sigurohuni që sipërfaqja e shtegut të jetë e rrafshuar, e formuar dhe e ngjeshur mirë për të parandaluar



- animin e panevojshëm ose kërcimin e pajisjeve;
- Vendosni njoftime paralajmëruese në të dyja anët e shtegut, në ose afër kunjave dhe përgjatë shtegut duke paraqitur lartësinë e lejuar të traverses dhe duke udhëzuar shoferët të ulin krahët e pajisjeve dhe ti mbajnë nën këtë lartësi gjatë kalimit;
- Mund të duhet që të ndriçoni njoftimet dhe traversën gjatë natës, ose në kushte të këqija të motit, për t'u siguruar që ato janë të dukshme;
- Sigurohuni që barrierat dhe kunjat të mirëmbahen.

## KONTROLLIMI I PUNËS

Nëse puna nën lartpërçues nuk mund të shmanget, duhet të sigurohen pengesa, kunja sinjalizues dhe njoftimet paralajmëruese.

Masat paraprake të shënuara më poshtë duhet të ndërmerren për të menaxhuar rrezikun:

- **Leja e qasjes** - leja për qasje të sigurt nën lartpërçues duhet kërkuar nga pronari i linjës;
- **Përrjashtimi** - impianti, pajisjet ose mjetet e dorës që mund të tejkalojnë kufirin e distances së sigurt nuk duhet të kalojnë nën linjë;
- **Modifikimet** – impianti, siç janë vinçat dhe eskavatorët, duhet të modifikohen duke u krijuar kufizime të përshtatshme fizike shtesë në mënyrë që të mos të tejkalojnë kufirin e distancës së sigurt;
- **Shtesat** - vinça me krahë teleskopik ose anësorë mund të kenë nevojë për pajisje kufizuese shtesë për të parandaluar ndryshimin e gjatësisë së krahut ose këndit të krahut anësor; dhe
- **Mbikëqyrja** - hyrja për impiantet dhe materialet dhe puna e impiantit duhet të jetë nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të një personi të përshtatshëm i cili caktohet për të siguruar respektimin e masave paraprake të sigurisë.

## PROCEDURAT EMERGJENTE

Nëse dikush ose diçka bie në kontakt me një lartpërçues, është e rëndësishme që të gjithë personat e përfshirë të dinë se çfarë veprimi duhet të ndërmarrin për të zvogëluar rrezikun e pësimit të një goditje elektrike ose lëndime djegieje.

Pikat kryesore janë:

- Asnjëherë mos prekni telat e lartpërçuesëve;
- Supozoni se telat janë nën tension, edhe nëse nuk janë duke liru harqe apo shkëndija elektrike, ose nëse duket se nuk ka rrymë në to;
- Mos harroni se, edhe nëse linjat janë të shkyçura, ato mund të aktivizohen automatikisht pas disa sekondash ose në distancë pas disa minutash ose edhe orësh nëse pronari i linjës nuk është në dijeni që linja e tyre është dëmtuar;



- Nëse keni mundësi, telefononi shërbimet e urgjencës. Tregojani vendndodhjen tuaj, çfarë ka ndodhur dhe se çështja ka të bëjë me telat elektrik dhe kërkoni që të kontaktojnë pronarin e linjës;
- Nëse jeni në kontakt, ose afër një teli të dëmtuar, largohuni sa më shpejt të jetë e mundur dhe qëndroni larg derisa pronari i linjës t'ju informojë nëse situata është e sigurt: nëse jeni në një automjet që ka prekur një tel, ose qëndroni në automjet ose, nëse keni nevojë të dilni, hidhuni prej tij aq larg sa keni mundësi. Mos e prekni automjetin ndërsa qëndroni në tokë. Mos u ktheni në automjet derisa të konfirmohet se është e sigurt për ta bërë këtë;
- Jini të vetëdijshëm se nëse një tel me rrymë prek tokën, zona përreth tij mund të elektrizohet. Mbani një distancë të sigurt larg telit ose diçka tjetër që preket nga ai dhe mbajini të tjerët larg.

## ÇËSHTJET E NDRYSHME PËR PUNËN ME LARTPËRÇUES DHE KABLOT NËNTOKËSORE

- Përfshini punëtorët në kryerjen e Vlerësimeve të Rrezikut (VR)
- Mbikëqyrësit duhet të ofrojnë trajnime, prezantime të shkurtra dhe informime të bazuara në VR-të/Analiza të Sigurisë së Punës/Identifikimin e Rrezikut përpara se të kryejnë punën
- Vendosni orar të rregullt të mirëmbajtjes për pajisjet për gërmime, punime në lartësi dhe siguri.

## AUDITIMET

Punëdhënësi duhet të ketë auditime të brendshme/vetë-Inspektime sipas listës së sugjeruar në Shtojcë. Kjo do t'ju mundësojë atyre që të menaxhojnë në mënyrë efektive Shëndetin dhe Sigurinë dhe gjithashtu t'i përgatisë ata për çdo auditim të jashtëm siç janë Rregullatori (Inspektorati i Punës etj.) dhe Certifikimi, nëse ka të tillë.

## VËREJTJET PËRFUNDIMTARE

**MBANI MEND:** Ndjekja e udhëzimeve të mësipërme do të zvogëlojë rreziqet nga shërbimet nëntokësore dhe lartpërçuesit.

**Për më shumë informata, kontaktoni Inspektoratin e Punës.**



# SHTOJCA

Pyetjet e Auditimit të Punëdhënësit për “Energjinë Elektrike në Punë - Praktikat e Sigurta të Punës” (Udhëzuesi), siç janë marrë nga lista e kontrollit të konsoliduar të Auditimit të SSHP-së të BE-së, e zhvilluar në mars të vitit 2021, janë dhënë më poshtë.

## Seksionet referuese:

### 2.6.2. Kërkesat e përgjithshme të sigurisë për makineritë (Energji elektrike)

### 2.6.5. Kërkesat e përgjithshme të sigurisë për makineritë (Punimet tokësore)

1. A janë duke u zhvilluar aktivitetet e zakonshme në vendin e punës duke pas parasysh kontaktin e mundshëm me linjat ajrore të energjisë?
2. A janë gjetur dhe shënuar kabllo të fshehura të energjisë elektrike dhe kabllo të nëntokësore dhe a janë marrë masat paraprake për punë të sigurt?
3. A është kryer vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut për ndërtime/gërmime?
4. A është siguruar kontrolli për vendpunimet e veçanta (për secilin vendpunim)?
5. A është siguruar informacion dhe trajnim i mjaftueshëm për punonjësit në lidhje me rreziqet gjatë punimeve tokësore dhe masat e mundshme parandaluese?
6. A ka pasur konsultime me punëtorët (dhe përfaqësuesit e tyre) në lidhje me punimet tokësore?
7. A përcaktohen dhe sigurohen oraret e rregullta të mirëmbajtjes për pajisjet e gërmimit dhe pajisjet e sigurisë?
8. A ofrohen kontrole të rregullta në lidhje me sigurinë e gërmimit dhe a mbahen shënime/raporte?
9. A janë siguruar masat e nevojshme të sigurisë për të siguruar stabilitetin e gërmimit?
10. A sigurohen rrugët e sigurta të hyrjes/daljes në gërmim?
11. A sigurohet ventilim i mjaftueshëm ose furnizim me ajër në të gjitha zonat e punës kur punoni gjatë gërmimit?
12. A është siguruar që parrakët (rrethojat) rrethojnë gërmimin?
13. A janë siguruar kalime të sigurta gjatë gërmimit?
14. A janë ruajtur si duhet pajisjet dhe materialet e përdorura afër gërmimit?
15. A ka ndriçim të mjaftueshëm në zonat e punës së gërmimit?
16. A ka numër të mjaftueshëm të shenjave paralajmëruese të vendosura në zonat ku ato mund të shihen qartë?
17. A ka numër të mjaftueshëm të shenjave paralajmëruese të vendosura për të informuar publikun dhe a janë vendet e punimeve tokësore të rrethuara siç duhet?